



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKË SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 17/07/2019

**Nga:** Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

**Drejtuar:** Shoqërisë “I.D.K- KONSTRUKSION” shpk me NUIS K51408016J dhe me adresë: Rruga Zaja, Koder Berxulle, Vorë, Tiranë.

**Procedura e prokurimit: E hapur.**

**Numri i referencës së procedurës: REF-24631-05-30-2019.**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje bojë për sinjalistikë rrugore”, afati: 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 22, Date 03.06.2019.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Shoqëria “DEUTSCHCOLOR” sh.a me NUIS L21326504J dhe me vlerë 9.378.000 (nëntë milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH.
2. Shoqëria “ELDA-VL” shpk me NUIS K67106202W dhe me vlerë 0 lekë.
3. Shoqëria “GENTIAN HORIETI” p.f me NUIS K31427013J dhe me vlerë 6.962.000 (gjashtë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH.
4. Shoqëria “I.D.K- KONSTRUKSION” shpk me NUIS K51408016J dhe me vlerë 13.860.000 (trembëdhjetë milion e tetëqindë e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
5. Shoqëria “R.S. & M” shpk me NUIS K32203002I dhe me vlerë 16.568.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqindë e gjashtëdhjetë e tetë mijë) leke pa TVSH.

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

1. “DEUTSCHCOLOR” sh.a me NUIS L21326504J.

Përkatësisht për arsytet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 1/b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ku parashikohet se " 1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: ...b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1", pasi në pikën 6 të kësaj deklarate thuhet se : *Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*
  - a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur; pa u konsultuar; pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
  - b) *Ofertuesi është konsultuar; ka komunikuar; ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*

Operatori nuk ka klikuar asnjë nga alternativat dhe si rrjedhim deklarata konsiderohet e pavlefshme.

- Nuk përmbush pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar ku parashikohet se "*Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: 1.Kopje të çertifikuara të pasqyrave financiare të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2016,2017,2018), të konfirmuara nga Dega e Tatim Taksave si dhe të shoqëruara me Raportin e Auditimit Ligjor; vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar."* pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur raportet e auditimit ligjor të tre viteve (2016-2018), të cilat sipas parashkimit në nenin 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "*Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese: ....b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;...."* janë të detyrueshme për të gjitha shoqëritë aksionare.
- Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij."* Nga verifikimi i objektit të veprimtarisë së operatorit ekonomik "Deutschcolor" sh.a në Ekstraktin Tregtar (Import, eksport, tregtim llaçrash, përgatitje tullash, pajisje hidrosanitare, inerte, prodhime llaçrash të gatshme, të thatë, të parapërgatitura për ndërtim dhe rrugë, në thasë dhe rifuxho, me bazë çimento, allçie, bitumi, koll, llaç, fino, bojak, stuko, **bojra sintetike e natyrale me bazë pigmentesh hekuri dhe atyre organike**, prodhime me bazë silikatesh dhe përgatitje tullash, inerte të granulomentrisë, punime të ndryshme të të gjitha këtyre materialeve, import, eksport i të gjitha këtyre.), rezulton që është prodhues i **bojrave sintetike e natyrale me bazë pigmentesh hekuri dhe atyre organike** dhe nuk prodhon fosfor, katalizator dhe skoç. Mostrat e paraqitura për zërat "Fosfor", "Katalizator" dhe "Skoç" janë të tre kompanive të tjera prodhuese, përkatësisht kompania "CHIYE GLASSBEAD (HEBEI) CO., LTD " për fosforin, kompania "NOVICHEM" për katalizatorin dhe kompania "SELLOPLAST" për skoçin, për të cilat operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi.

- Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti CE, lëshuar nga institucione të specializuara për të gjithë mallrat, objekt prokurimi (referoju shtojcës 12)*" pasi deklaratat e paraqitura nuk kanë të shënuar emrin, logon, vulën apo elementë të tjerë të ndonjë institucioni të specializuar për këtë qëllim por mbajnë logon dhe vulën e shoqërisë "Deutschcolor" sh.a, e cila nuk konsiderohet institucion i specializuar.
- Nuk përmbush pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë për artikujt objekt prokurimi, katalogun dhe skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.*" pasi skedat teknike të paraqitura për zërat fosfor dhe katalizator janë me logon e kompanisë "Deutschcolor" sh.a, ndërsa mostrat e tyre janë të dy kompanive të tjera prodhuese, përkatësisht kompania "CHIYE GLASSBEAD (HEBEI) CO., LTD" për fosforin dhe kompania "NOVICHEM" për katalizatorin. Si rrjedhim, ka mospërputhje midis skedave teknike dhe mostrave të paraqitura për këto dy zëra.
- Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë raportet e testimi sipas EN 1871, EN 1436, EN 12802, EN 13197, nga laboratore të çertifikuara dhe akredituar, ku të plotësohen standartet e dhëna në specifikimet teknike.*" pasi raportet e testimi të paraqitura nuk janë sipas standarteve të kërkuara më lart dhe janë të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, në kundërshtim me kriteret e përgjithshme të pranimit / kualifikimit ku thuhet se "*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe*".

## 2. "ELDA-VL" shpk me NUIS K67106202W.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument.

## 3. "GENTIAN HORIETI" p.f me NUIS K31427013J

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëb-site kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*" Operatori ekonomik "Gentian Horieti" PF, ka paraqitur autorizim prodhuesi vetëm nga shoqëria italiane "Nuova Maric", e cila prodhon bojë për sinjalistikë dhe nga shoqëria shqiptare "Logo Film" sh.p.k, e cila prodhon skoç. Mostrat e paraqitura për zërat "Fosfor" dhe "Diluent" janë të dy kompanive të tjera prodhuese, përkatësisht kompania "Interminglass Sp.zo.o ( IMG)" për fosforin dhe kompania "PPG" për diluentin, për të cilat operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi.
- Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti CE, lëshuar nga institucione të specializuara për të gjithë mallrat, objekt prokurimi (referoju shtojcës 12)*" pasi nuk ka paraqitur deklaratat përkatëse sipas parashikimit të mësipërm.
- Nuk përmbush pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë për artikujt objekt prokurimi, katalogun dhe skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me*

*logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.”* pasi skedat teknike të paraqitura për zërat fosfor dhe diluent janë me logon e kompanisë “Nuova Maric” ndërsa mostrat e tyre janë të dy kompanive të tjera prodhuese, përkatësisht kompania “Interminglass Sp.zo.o ( IMG) ” për fosforin dhe kompania “PPG” për diluentin. Si rrjedhim, ka mospërputhje midis skedave teknike dhe mostrave të paraqitura për këto dy zëra.

- Gjithashtu operatori ekonomik nuk ka paraqitur skedë teknike për zërin “Katalizator”.
- Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku parashikohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë raportet e testimit sipas EN 1871, EN 1436, EN 12802, EN 13197, nga laboratore të certifikuar dhe akredituar,ku të plotësohen standartet e dhëna në specifikimet teknike.” pasi nuk ka paraqitur raportet përkatëse sipas parashikimit të mësipërm.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik **“I.D.K- KONSTRUKSION” shpk me NUIS K51408016J** dhe me adresë: Rruga Zaja, Koder Berxulle, Vorë, Tiranë se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **13.860.000** (trembëdhjetë milion e tetëqindë e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, **është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga “5 Maji”**, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **16.568.000** (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqindë e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 09.07.2019.

Ankesa: Nuk ka.